

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 3889 Rep.
NR. 959 Kol.

**KONTRATË SHITESË KONCESIONI
PËR
DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”
(NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE
“BACKA 1”, “BACKA 2”, “BACKA A”, “BACKA B” DHE “BACKA C”**

Në Tiranë, më datë 27, muaji KORRIK, viti 2020 (dymijë e njëzetë), para meje noter Alket Skendaj, anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë Pallati i Shallvareve, përballë Tajvanit, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 5590 Prot. datë 23.07.2020 (kopje bashkëlidhur) nga Z. Ilir Tomorr Bejtja, lindur në _____ më datë _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftim ID Nr. _____ dhe Nr. personal _____

DHE

Shoqëria Koncesionare “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., themeluar si person juridik më datë 20.07.2012 dhe rregjistruar në QKR datë 26.07.2012, me NIPT L29326401S, e përfaqësuar ligjërisht nga administratori i shoqërisë Znj. Flutura Ismaili, lindur në _____ më datë _____, madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u sigurova nga Letërnjoftim ID me Nr. personal _____

të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:


Të lidhin këtë Kontratë Shtesë Koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim–Operim–Transferim), me Nr. 1616 Rep, Nr. 374 Kol, lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritetit Kontraktues) dhe shoqërisë “Alba Konstruksion” sh.p.k (Koncesionari) për ndërtimin e Hec-eve “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B”, “Backa C”, nënshkruar nga palët dhe hyrë në fuqi datë 26.06.2012.



Hyrje

Duke pasur parasysh dhe referuar:

- Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe shoqërisë “Alba Konstruksion” sh.p.k (Koncesionari) është lidhur Kontrata e Koncesionit të formës “BOT” për ndërtimin e Hec-eve “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B”, “Backa C”, nënshkruar nga palët dhe hyrë në fuqi datë 26.06.2012.
- Shkresës me Nr. 20 Prot. datë 25.06.2020 “*Kthim përgjigje*”, protokolluar në MIE me Nr. 3059/5 Prot. datë 25.06.2020, me anë të të cilës shoqëria koncesionare “Kroi Mbret Energji” shpk ka paraqitur në MIE preventimin e punimeve në 4 kopje, si dhe sigurimin e kontratës koncesionare për reflektimin e ndryshimit të parametrave të Kontratës Koncesionare sipas projektit të zbatimit të ripunar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktues;
- Shkresës me Nr. 21 Prot. datë 17.07.2020 “*Mbi kontratën shitesë të koncesionit*”, me anë të të cilës shoqëria koncesionare “Kroi Mbret Energji” shpk ka paraqitur në MIE kërkesën për mbështetje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktues) për të rishikuar nenin 10, pika 2 “Programi i Punimeve” (shtyrjen me 6 muaj) me qëllim realizimin e kontratës për ndërtimin e hidrocentraleve Backa, duke marrë parasysh zbatimin e projektit të ndryshuar dhe miratuar nga AK dhe gjendjen e shkaktuar nga pandemia Covid19;
- Shkresës Nr. 92/1 Prot. datë 27.03.2013 të Autoritetit Kontraktues (METE-s), nëpërmjet të cilës është dërguar në AKBN projekti zbatimit për kryerjen e oponencës teknike dhe shkresës së AKBN-së Nr. 2296/2 Prot. datë 03.04.2013 mbi oponencën teknike të projektit të zbatimit, dhe shkresës së Autoritetit Kontraktues (METE-s) Nr. 92/3 Prot. datë 04.04.2013, nëpërmjet të cilës është miratuar projekti i zbatimit për Hec-et Backa 1, Backa 2, Backa A, Backa B dhe Backa C;
- Shkresës së shoqërisë koncesionare “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. (Nr. 92/11 Prot., datë 10.06.2014), e paraqitur në MEI për miratim Projektin e Zbatimit të ndryshuar të hidrocentraleve “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B” dhe “Backa C”, projekt i cili u përcoll për kryerjen e oponencës teknike në AKBN me shkresën Nr. 92/13 Prot, datë. 10.10.2014 dhe shkresës së AKBN Nr. 1692 Prot, datë 03.02.2015, protokolluar në MEI me Nr. 92/14 Prot, datë 03.02.2015, me anë të të cilës ka dërguar oponencën teknike për vlerësim pranë Autoritetit Kontraktues;
- Shkresës së MEI me Nr. 92/15 Prot. datë 16.02.2015, nëpërmjet të cilës është miratuar ndryshimi i projektit të zbatimit të Hec-eve “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B” dhe “Backa C”;



- Shkresës Nr. 23 Prot. datë 22.10.2019 *“Kërkesë për ndërhyrje të zgjidhjes së problematikave për objektin ndërtim i hidrocentralit “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B” dhe “Backa C”, protokolluar në MIE me Nr. 9113 Prot. datë 21.10.2019, ku shoqëria koncesionare “Kroi Mbret Energji” sh.p.k informon mbi disa problematika të ndeshura gjatë zbatimit të punimeve të projektit për ndërtimin e hidrocentraleve “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B” dhe “Backa C” siç janë intersektimi i gjurmës së projektit me linjën Gazsjellës Trans Adriatik (TAP), të cilat e kanë detyruar shoqërinë të kërkojë ndryshimin e projektit të zbatimit;*
- Shkresës Nr. 3059 Prot. datë 09.04.2020 ku MIE i ka kërkuar AKBN-së vijimin e procedurës së vlerësimit të projektit të zbatimit të ndryshuar të shoqërisë koncesionare “Kroi Mbret Energji” sh.p.k, për ndërtimin e hidrocentraleve *“Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B” dhe “Backa C”;*
- Shkresës së AKBN Nr. 1958/1 Prot datë 16.04.2020 *“Dërgohet raporti oponencës teknike i vlerësuar për projektin e zbatimit të ndryshuar të Hec-eve Backa 1, A, dhe C”, protokolluar në MIE me Nr. 3059/1 Prot. datë 16.04.2020, me anë të të cilës AKBN ka dërguar në MIE oponencën teknike dhe një kopje të dokumentacionit të këtij projekt zbatimi të ndryshuar të vulosur;*
- Referuar Relacionit të Oponencës Teknike të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), dërguar nga AKBN me shkresën Nr. 1958/1 Prot. datë 16.04.2020 *Mbi projektin e zbatimi të ndryshuar të Hec-eve Backa 1, A, dhe C të shoqërisë koncesionare Kroi Mbret Energji sh.p.k, vlerësuar me raportin e oponencës teknike, ku AKBN shprehet se skema e ripunuar e shfrytëzimit hidroenergjitik (e cila paraqitet në hartën me shkallë 1:25 000 për pellgun ujëmbledhës përkatës me objektet hidroteknike e parashikuara me treguesit teknik) respekton kufijtë e sipërm dhe të poshtëm koncesionare të Kontratës përkatëse, pra objekti shtrihet brenda kufijve koncesionare;*
- Shkresës Nr. 3059/4 prot., datë 18.06.2020 *“Miratohet projekti i zbatimit i hidrocentraleve “Backa”, ku Autoriteti Kontraktues është shprehur për pasqyrimin në kontratë të ndryshimeve të kuotave të hidrocentraleve “Backa 1, A, dhe C”, në përputhje me projektin e zbatimit të ripunuar;*
- Mbështetur në nenin 28 “Ndryshime” të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se kjo kontratë mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim të dy palëve; si dhe
- Në nenin 29 “Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit” të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari zotohen të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit;

Në Kontratën e Konçesionit të formës "BOT" me Nr. 1616 Rep, Nr. 374 Kol, për ndërtimin e Hec-eve "Backa 1", "Backa 2", "Backa A", "Backa B", "Backa C", nënshkruar nga palët dhe hyrë në fuqi datë 26.06.2012, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 1 "*Përkufizime dhe interpretime*",

në pikën 1.5, shprehja: "...me fuqi të instaluar 7,320 (shtatë mijë e treqind e njëzetë) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 33, 145, 644 (tridhjetë e tre million e njëqind e dyzet e pesë e gjashtëqind e dyzet e katër) kWh", zëvendësohet me shprehjen: ".....me fuqi totale të instaluar 6, 623 (gjashtë mijë e gjashtëqind e njëzet e tre) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 17 854 610 (shtatëmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e katërmijë e gjashtëqind e dhjetë) kWh".

Neni 3

Neni 3, "*Karakteristikat e hidrocentraleve*", ndryshohet si më poshtë:

Pika 3.1 Hidrocentralet "Backa "1, A dhe C" do të shfrytëzojnë ujërat e lumit të Staraveckës, degë e lumit Osum, bashkia Skrapar. Sipas projektit të zbatimit të ndryshuar parametrat hidroenergjitike të hidrocentralit do të jenë:

Hidrocentrali "Backa 1"

- Kuota e veprës së marrjes	703 m.m.n.d.
- Kuota e godinës së centralit	450 m.m.n.d.
- Energjia mesatare vjetore e energjisë kWh	8, 860, 159 kWh/vit
- Fuqia totale e instaluar kW	3 366 kW

Hidrocentrali "Backa C"

- Kuota e veprës së marrjes C-1	952.9 m.m.n.d.
- Kuota e veprës së marrjes C-2	969 m.m.n.d.
- Kuota e veprës së marrjes C-3	985 m.m.n.d.
- Kuota e godinës së centralit	700 m.m.n.d.
- Kuota e godinës së centralit	450 m.m.n.d.
- Energjia mesatare vjetore e energjisë kWh	4, 935, 624 kWh/vit
- Fuqia totale e instaluar kW	1 910 kW

Hidrocentrali "Backa A"

• Kuota e veprës së marrjes	1595,8 m.m.n.d.
• Kuota e veprës së marrjes	1595 m.m.n.d.
• Kuota e godinës së centralit	960 m.m.n.d.
• Energjia mesatare vjetore e energjisë kWh	4, 058, 827 kWh/vit
• Fuqia totale e instaluar kW	1 347 kW

Neni 8

Në nenin 8 "Detyrimet e koncesionarit", në pikën 8.4, shprehja "Të zbatohet preventivin e paraqitur sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kontratës", zëvendësohet me shprehjen "Të zbatohet preventivin e miratuar dhe vulosur nga AKBN sipas Aneksit 1 bashkëlidhur shtesës së kontratës".

Në nenin 8 "Detyrimet e koncesionarit", në pikën 8.6, shprehja "...me fuqi totale të vendosur në sasinë jo më pak se 7,350 kW (shtatë mijë e treqind e njëzetë)", zëvendësohet me shprehjen "...me fuqi totale të vendosur në sasinë jo më pak se 6, 623 (gjashtë mijë e gjashtëqind e njëzet e tre) kW". Detyrimet kontraktuale mbi prodhimin e energjisë elektrike mbeten ato të përcaktuara në Kontratën e Koncesionit, në të kundërt Autoriteti Kontraktues do të aplikojë sanksionet përkatëse që rrjedhin nga mospërmbushja e këtyre detyrimeve.

Neni 10

Neni 10.2 zëvendësohet me shprehjen "Koncesionari merr përsipër të vendosi në punë hidrocentralet "Backa "1, A dhe C" brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate shtesë.

PALET

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Përfaqësuar me Autorizim Nr. 5590, datë 23.07.2020
të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nga:

Z. Ilir Bejtja
ZV. MINISTËR



SHOQËRIA KONCESIONARE

"Kroi Mbret Energji" Shpk

Përfaqësuar nga:

Zj. Flutura Ismaili
ADMINISTRATORE